

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – Departamenti i përgjithshëm, Divizioni penal përmes gjyqëtarit të vetëm gjykues Islam Thaçi, me sekretaren Rafete Sylja, në lëndën penale kundër të pandehurit, E. Sh., për shkak të veprës penale, blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 paragrafi 2, të KPRK -së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore, Departamenti për krime të përgjithshme në Gjiilan, (PTH), PP.II.nr.1726/15, të datës 15.10.2015, duke vendosur sipas kërkesës së PTH për dhënien e urdhërit ndëshkimor, më datën 12.02.2016, hartoi këtë

AKTGJYKIM

PRANOHET kërkesa e PTH në Gjilan, PP.II.nr. 1726/15, të dates 15.10.2015 për dhënjen e urdhërit ndëshkimor ndaj të pandehurit,

E. R. Sh., i lindur më ..., në fh. Gj., me vendbanim në rr. ...,pn, ka të kryer shkollën e ..., ... martuar,i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

ë s h t ë f a j t o r

Sepse më2016, rreth orës ... min, në rrugën Gj. – M., në afërsi të restorantit ... në Gj., te i pandehuri B. M., është gjetur supstancë narkotike e llojit "...", në atë mënyrë që përderi sa polici, A. D., me një polic tjetër kishin qenë në patrollim e siper , i pandehuri B. M. , posa i vëren , i njejt i e hudhë në tokë, një qese plastike me supstancë narkotike , me ç’rast supstanca narkotike sekuestrohet nga policia , ndërsa i pandehuri sillet në stacionin e policisë dhe me rastin e intervistimit, i njejt i e pranon se supstanca narkotike e gjetur ishte e tij, ndërsa nga njësia DHNT –së , sasia e narkotikut të gjetur te i dyshuari , pas matjes dhe bërjes së testit fushor, ka rezultuar se është e llojit Mariuhanë dhe peshon 0,6 gram, në këtë mënyrë është vertetur se i pandehuri me veprimet e veta pa leje dhe autorizim ka poseduar substancë të rrezikshme narkotike,

Me çka ka kryer veprën penale, posedimi i pa autorizuar i narkotikëve, supstancave psikotropike ose analoge nga neni 275 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së,

andaj gjykata në bazë të dispozitës së sipërtheksuar ligjore si dhe në mbështetje të neneve: 4,41,46,dhe 73 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPK-së,të pandehurin e,

G J Y K O N

Me dënim gjobë në shumë prej 200.-€ (dyqindë)Euro, të cilën dënim i pandehuri, do ta arkëtoj në afat prej 15 ditësh nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

Nëse i pandehuri refuzon që ta arkëtoj dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje ta arkëtoj atë, atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim, në atë mënyrë që për çdo 20 €, të dënimin me gjobë do të caktohet nga një ditë burgim.

Obligohet i pandehuri që ta arkëtoj paushallin gjyqësor,në shumë prej 20 €,në afat prej 15 ditësh nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

Të pandehurit, B. M., substanca narkotike e llojit Mariuhanë me peshë pre 0,6 gram i konfiskohet.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore, Departamenti i përgjithshëm në Gjilan, ka ngritur aktakuzë PP.II.nr.114/2016, të datës 18.01.2016, kundër të pandehurit, B. M., për shkak të veprës penale posedimi i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotropike ose analoge nga neni 275 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, pastaj PTH , ka paraqitur kërkesën, PP.II.nr.114/2016,të datës 18.01.2016, për dhënien e urdhërit ndëshkimor dhe ka kërkuar që të pandehurit t'i shqiptohet dënim me gjobë, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor me arsyetimin se janë plotsuar kushtet ligjore për një gjë të tillë, sipas nenit 493 paragrafi 1 të KPPK-së.

Gjykata konsideron se provat e bashkangjitura aktakuzës së PTH në Gjilan me kërkesën për dhënien e urdhërit, PP.II.nr.114/2016, të datës 18.01.2016, kallximin penal nr. 2016-DHTN-013, të dat. 11.01.2016,Procesverbali i intervistimit të të dyshuarit,me numër dhe datë si më lartë,raporti i Drejtorisë së Hetimeve Trafikimit të Narkotikëve ,2016-DHTN-013 të dat. 10.01.2016,vërtetimi i sekuestrimit e përkoshëm të sendeve me date 10.01.2016, ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënien e urdhërit ndëshkimor me bindje se edhe ky dënim i shqiptuar do të ndikoj pozitivisht te e pandehura dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi I dënimit nga neni 41 të KPPRK-së.

Aandaj gjykta e miratoi kërkesën e PTH nga Gjilani dhe të pandehurin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi urdhër ndëshkimor dënimit me gjobë në shumën prej 200.€ (dyqindë) Euro,

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale,si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 453 paragrafi 1të KPPRK-së.

Të pandehurit,B. M., konform nenit 275 paragrafi 3 I KPRK-së, i konfiskohet substanca narkotike e llojit Mariuhanë me pesë prej 0,6 gram.

Nga të cekurat si më lartë dhe në bazë të nenit 495 të KPPRK-së,është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi .

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – Departamenti i përgjithshëm,Divizioni penal

P.nr.153/16,më 10.02.2016

**Sekretarja Juridike
Rafete Syla**

**Gjyqtari
Islam Thaçi.d.v.**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi–urdhërit ndëshkimor mund të ushtrohet kundërshtim në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të të njejtit. Kundërshtimi i dorëzohet kësaj gjykate.